



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT**

**Seksioni për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor dhe të të tretëve që  
veprojnë për llogari të tyre**

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

[Tel/Fax:+355 4 2380 300/315](tel:+35542380300315)  
[E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

**Nr. Prot.**  
**Nr. Dok.202100322/17**

**Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2024**

**Lënda :** *Rekomandohet mbështetja në hartimin dhe zbatimin e projektit për ndërtimin e sistemit të kanalizimeve për shkarkimin e ujërave të zeza në zonën e Fshatit Hamallaj, Durrës, dhe më gjerë.*

*Rekomandohet mbështetja e nevojshme financiare e Shoqërisë Rajonale të Ujësjetës-Kanalizimeve sha, Durrës, për ndërtimin e sistemit të kanalizimeve për shkarkimin e ujërave të zeza në zonën e Fshatit Hamallaj, Durrës, dhe më gjerë.*

**Drejtuar: Bashkia**

**DURRËS**

**Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë**

**TIRANË**

**Agjencisë Kombëtare të Ujësjetës-Kanalizimeve**

Pranë: Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë

**TIRANË**

**Bashkia**

**Bashkia**

**KAVAJË**

**Bashkia**

**KRUJË**

**Bashkia**

**SHIJAK**

**RROGOZHINË**

**Për dijeni: Shoqëria Rajonale e Ujësjellës Kanalizimeve sha**

**DURRËS**

Të nderuar!

Institucioni i Avokatit të Popullit, në funksion të ushtrimit të kompetencave kushtetuese dhe ligjore, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të shtetasve nga veprimet apo mosveprimet e organeve të administratës publike, duke marrë shkas nga problematika e ndotjes nga ujërat e zeza të banesave në zonën e Fshatit Hamallaj, Durrës, bërë publike në rrugë mediatike<sup>1</sup>, në përputhje me nenin 13, të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "*Për Avokatin e Popullit*", i ndryshuar, ka marrë në shqyrtim këtë çështje me iniciativë.

Sikundër thuhet shprehimisht në artikullin e medias, ujërat e zeza kanë prekur banesat e banorëve të zonës në Hamallaj, Durrës, Kanalizimet e ujërave të bardha e të zeza me rastin e rënies së shirave janë përzier dhe kthyer mbrapsht nëpër banesat e banorëve të kësaj zone. Për zgjidhjen e situatës, banorët kanë kërkuar ndërhyrjen e Bashkisë Durrës, por askush nuk ka ndërmarrë masa për t'i dhënë zgjidhje problemit.

Institucioni i Avokatit të Popullit duke e vlerësuar të drejtë dhe të ligjshëm shqetësimin e ngritur nga banorët, kërkon vëmendjen tuaj për trajtimin e kësaj problematike tepër shqetësuese që dëmton shëndetin e qytetarëve dhe cilësinë e jetës së komunitetit përreth.

---

<sup>1</sup> <https://www.syri.net/politike/404720/ndertuesit-ua-cuan-ujrat-e-zeza-drejt-e-ne-shtepi-hamallaj-ngrihet-ne-ne-proteste/>

Nisur sa më sipër, kemi kërkuar shpjegime Bashkisë Durrës dhe “*Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës-Kanalizimeve, Durrës*”, Sha sipas kompetencave ligjore për këtë problematikë, për sa i përket trajtimit që po i bëhej kësaj çështjeje dhe masave që do të ndërmerreshin për zgjidhjen e saj.

Në përgjigjen e dhënë me shkresat nr. 3259/1 prot, datë 26.03.2024, dhe nr. 3259/3 prot, datë 15.08.2024, Bashkia Durrës, na sqaron se: “... *Bashkia Durrës, nuk harton projekte për sistemimin/rehabilitimin e rrjetit të ujërave të zeza, kjo kompetencë është e “Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës-Kanalizimeve, Durrës”, Sha.*”.

Në përgjigjen e dhënë fillimisht me shkresën nr. 2429/1 prot., datë 25.05.2021, “*Shoqëria Rajonale e Ujësjellës-Kanalizimeve Durrës*”, Sha, na sqaron ndër të tjera, se:

*“... në këtë zonë Shoqëria jonë nuk kryen shërbime kanalizimi, dhe në sistemin e faturimit këta banorë janë të përjashtuar nga tarifa e këtij shërbimi”.*

Në vazhdim të përgjigjes, me shkresën nr. 807/2 prot, datë 14.04.2022, “*Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizimeve Durrës*”, Sha sqaron se:

*“ ... Shoqëria jonë nuk kryen shërbime kanalizimi në këtë zonë, pasi nuk ka rrjete kanalizimi ...*

*... zgjidhja e problematikës nuk është kompetencë e shoqërisë sonë, pasi mirëmbajtja dhe pastrimi i kanaleve të hapura, si kanale të treta, nuk janë në administrim të shoqërisë tonë...*

*... për sa i përket kërkesës së banorëve për investim, theksojmë se Shoqëria jonë e ka të pamundur investimin e një rrjeti kanalizimi në këtë zonë, pasi fondi që do të duhej për një investim të tillë është jashtë kapaciteteve financiare të shoqërisë tonë”.*

Në vijim të informacionit dhe shpjegimeve, me shkresën nr. 3904/2 prot, datë 21.08.2024, “*Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizimeve Durrës*”, Sha, bën me dije, se:

*“... “Shoqëria Rajonale Ujësjiellës-Kanalizimeve Durrës”, Sha në pamundësi fondesh, nuk mundet të hartojë projektin për zonën në fjalë, pasi është një zonë shumë e shtrirë. Nëse do të hartohet një projekt i tillë nuk do të duhej vetëm për zonën e Hamallajt, por për të gjithë zonën e Ishmit, Manzës, Sukthit Arapaj, etj.*

*Çdo subjekt familjar apo biznes privat që nuk ka mundësi të shkarkojë në rrjet, e ka detyrim ligjor t’i nënshtrohet Aktit normativ nr. 08, datë 28.12.2023, si dhe Rregullores Teknike, e cila ndiqet nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës”.*

Po ashtu, për këtë çështje, Agjencia Kombëtare e Ujësjiellës Kanalizimeve (AKUK), me shkresën nr. 128/1 prot, datë 06.02.2023, drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit, informon se:

*“... Agjencia Kombëtare e Ujësjiellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve përgatit nevojat për investime për ndërtimin e infrastrukturës së plotë të ujësjiellës-kanalizimeve, bazuar në prioritetet e Qeverisë, masterplanit të Ujësjiellës-Kanalizimeve dhe projekteve të depozituara në Agjencinë Kombëtare të Ujësjiellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve.*

*Bashkia Durrës apo “Shoqëria Rajonale e Ujësjiellës-Kanalizimeve Durrës”, Sh.a. në juridiksionin e së cilës ndodhet zona e Hamallaj dhe Spitallës, nuk ka depozituar projekt në Agjencinë Kombëtare të Ujësjiellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve për ndërtimin e kanalizimeve të ujërave të zeza në këtë zonë.*

*Me dorëzimin dhe plotësimin e projektit, AKUM do të shikojë mundësitë buxhetore për financimin e tij”.*

Referuar informacionit dhe shpjegimeve të dhëna prej organeve të përmendura, konstatohet, se:

- Problematika e ndotjes nga ujërat e zeza të banesave në Fshatin Hamallaj ekziston;
- Mungon sistemi i kanalizimeve për shkarkimin e ujërave të zeza në zonën e Fshatit Hamallaj, Durrës, dhe më gjerë.
- Ndodhemi në kushtet e fragmentarizimit të shërbimeve publike si dhe mungesës së dhënies së shërbimeve bazë midis Bashkisë Durrës dhe

Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjitikës (MIE), për zgjidhjen e problemit të përbashkët. Referuar *“Ekstraktit historik të regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit “Shoqëri aksionare”, të “Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës-Kanalizime Durrës”*, Sha, publikuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, rezulton se MIE zotëron 51% të aksioneve të kësaj Shoqërie dhe Bashkia Durrës 32.47% të aksioneve. Përqindjet e tjera të aksioneve zotërohen prej Bashkisë Krujë, Kavajë, Shijak dhe Rogozhinë. Data e themelimit të *“Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës-Kanalizime Durrës”* Sha, sipas *“Ekstraktit historik i regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit “Shoqëri aksionere”* të Qendrës Kombëtare të Biznesit, është 13.07.2022, dhe e regjistrimit në këtë Qendër, data 31.08.2022, me pjesëmarrje në aksione si më sipër përmendur;

- *“Shoqëria Rajonale e Ujësjetllës-Kanalizimeve Durrës”*, Sha nuk ushtron shërbim për largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura në Fshatin Hamallaj Durrës, dhe më gjerë, për shkak të mungesës së sistemit të kanalizimeve për shkarkimin e ujërave të zeza, sikurse bërë e ditur në shkresën nr. 3259/1 prot, datë 15.08.2024 të Bashkisë Durrës, si dhe shkresën nr. 3904/2 prot, datë 21.08.2024, të *“Shoqëria Rajonale e Ujësjetllës-Kanalizimeve Durrës”* Sha, drejtuar Avokatit të Popullit;
- *“Shoqëria Rajonale e Ujësjetllës-Kanalizimeve Durrës”*, Sha adreson gabim zgjidhjen e problematikës së çështjes sipas Aktit normativ nr. 08, datë 28.12.2023, si dhe Rregullores Teknike, e cila ndiqet nga MIE. Qëllimi i këtij aktit normativ është trajtimi i ujërave të ndotura nëpërmjet vendosjes së impiantit apo sistemit të grumbullimit, trajtimit dhe largimit të ujërave të ndotura nga ana e subjekteve, të cilat kryejnë veprimtari ekonomike në zonat bregdetare dhe bregun e liqeneve e të lumenjve, të cilat nuk i trajtojnë ujërat e ndotura, të krijuara nga veprimtaria e tyre ekonomike, dhe i shkarkojnë ato pranë ose në ujëra larëse. Zona e Hamallajt, Durrës, nuk ndodhet pranë ujërave larës, dhe se, subjektet/individët e prekur nga problematika nuk ushtrojnë veprimtari ekonomike në zonat bregdetare dhe bregun e liqeneve e të lumenjve.

Për sa më sipër, në vlerësim të përgjigjes së dhënë nga Bashkia Durrës dhe *“Shoqëria Rajonale e Ujësjetllës-Kanalizimeve, Durrës”*, Sha, konstatohet se, ndonëse problematika është e hershme, rezulton se nga institucionet

përgjegjëse akoma nuk është përgatitur një plan masash për zgjidhjen përfundimtare të saj. Në këtë kuptim, Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson, se institucionet përgjegjëse në ushtrim të funksioneve të tyre dhe bazuar në problematikën e konstatuar, duhet të kishin planifikuar shumë kohë më parë, planin e masave dhe buxhetin përkatës për investime në infrastrukturë.

AKUK, krijuar mbi bazë të VKM-së nr. 431, datë 11.07.2018 *“Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve”*, ndryshuar me VKM nr. 617, datë 01.11.2023, Urdhërit të Kryeministrit nr. 13, datë 21.01.2019 *“Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve”*, Udhërit nr. 88, datë 24.02.2020 *“Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve”* të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, ka të përcaktuara në këto akte nënligjor, objektin e veprimtarisë si dhe detyrat funksionale. AKUK ka për objekt të veprimtarisë së saj në fushat e përgjigjjes sipas përcaktimeve të bëra në VKM-në nr. 431, datë 11.07.2018, pika 13, të ndryshuar:

- mbështetjen teknike të ministrisë së linjës për hartimin dhe zbatimin e politikave e të programeve e strategjive në fushën e ujësjellës-kanalizimeve dhe dhe trajtimin e ujrave të ndotura;
- drejtimin e punës për hartimin dhe kostimin e planit strategjik të ndërhyrjeve infrastrukturore duke garantuar zbatueshmërinë dhe përditësimin e vazhdueshëm të tij;
- planifikimin e nevojave për investime për ndërtimin, rehabilitimin, zgjerimin e sistemeve të ujësjellës-kanalizimeve, të impjanteve të trajtimit të ujrave të ndotura, bazuar në programet e qeverisë dhe në masterplanet kombëtare;
- monitorimin e detyrimeve për përmbushjen e objektivave strategjike, afatgjatë, afatmesëm dhe afatshkurtër, në kuadër të Strategjisë Kombëtare të Ujit dhe programeve të zhvillimit të sektorit;
- shërbimin e koordinimit dhe asistuesit të institucioneve qendrore dhe njësisive të vetëqeverisjes vendore e të ujësjellës-kanalizimeve, kur kërkohet ose përcaktohet nga kuadri ligjor për nismat për investime në

fushat e ujësjellës-kanalizimeve dhe trajtimit të projekteve në këto fusha;

- orientimin nga pikëpamja teknike e menaxheriale si dhe bashkëpunimin për të gjitha projektet e ujësjellës-kanalizimeve, të impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura, të financuara nga buxheti i shtetit, buxheti i bashkisë, buxheti i shoqërisë “Ujësjellës-Kanalizime” sha, apo institucione financiare ndërkombëtare;
- bashkëpunimin me njësitë e vetëqeverisjes vendore ose shoqëritë UK, si dhe jep mendim për projektet teknike të ndërhyrjeve infrastrukturore pavarësisht burimit të financimit apo autoritetit kontraktor, me qëllim garantimin dhe zbatimin e rregullave teknike të projektimit, zbatimit e shfrytëzimit dhe monitoron ecurinë e tyre;
- ...
- Koordinimin e nismave për investime në fushën e ujësjellës-kanalizimeve, në bazë të rëndësisë strategjike, si dhe merr pjesë e ofron këshillime gjatë procesit të hartimit të projekteve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve. Përgatitjen e projekteve zhvillimore dhe projekteve pilot, me kërkesë të bashkive, qarqeve dhe ministrive apo institucioneve të tjera të administratës publike;
- ...
- Organizohet si pjesë e subjektit të kompetencave të përbashkëta, sipas VKM-së nr. 302, datë 11.05.2022, ..., dhe ushtron funksionet, në përputhje me këtë vendim dhe ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.
- ...
- Siguron mbështetjen e nevojshme financiare për shoqëritë aksionare të ujësjellës-kanalizimeve, sipas plan biznesit të miratuar, kur ky plan mund të mbulohet nga të ardhurat e vetë shoqërisë;

Për situatën e krijuar në zonën e Hamallajt, e më gjerë, Institucioni i Avokatit të Popullit, vlerëson se është përgjegjësi dhe neglizhencë e organeve qendrore dhe vendore, të cilët duhet të kishin marrë të gjitha masat e duhura për të kontrolluar dhe monitoruar territorin, lidhur me çështjen në trajtim.

Sa më sipër, ushtrimi i detyrave tuaja funksionale dhe marrja e masave të menjëhershme për garantimin e një mjedisi të shëndetshëm, përbën nevojë emergjente duke pasur parasysh dhe Direktivën Kuadër për Ujërat

(2000/60/EC) dhe Direktivën për Trajtimin e Ujërave të Ndotura Urbane (91/271/EEC)<sup>2</sup> që synojnë mbrojtjen e shëndetit të njeriut<sup>3</sup>. Çështja e sigurimit të disponueshmërisë dhe menaxhimit të qëndrueshëm të ujit dhe kanalizimeve për të gjithë është një prej objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm për vendin tonë.

Më tej duke u fokusuar në njohjen e standardeve ndërkombëtare, theksojmë faktin se Rezoluta 64/292 e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, njeh të drejtën për ujë të pijshëm dhe kanalizime të sigurta dhe të pastërta, si një ‘e drejtë e njeriut’ që është thelbësore për gezimin e plotë të të gjitha të drejtave. Asambleja e Përgjithshme<sup>4</sup> u bën thirrje Shteteve dhe organizatave ndërkombëtare që të ofrojnë burime financiare, ngritje kapacitetesh dhe transferim teknologjie, nëpërmjet ndihmës dhe bashkëpunimit ndërkombëtar, veçanërisht për vendet në zhvillim, në mënyrë që të shtojnë përpjekjet për të siguruar ujë të pijshëm dhe kanalizime të sigurta, të pastërta, të aksesueshme për të gjithë.

Shqipëria është një nga vendet që ka nënshkruar Deklaratën e Mijëvjeçarit duke u angazhuar në arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit deri në vitin 2015, dhe në shtatëmbëdhjetë Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm (OZHQ), të cilat kanë si afat vitin 2030. Në këtë axhendë të re të zhvillimit, uji dhe kanalizimet konsiderohen të kenë rol kyç në të gjitha dimensionet e zhvillimit të qëndrueshëm, për sa ato kanë lidhje me disa probleme kryesore globale dhe kanë ndikim në të gjitha aktivitetet njerëzore.

Ndër të tjera, për herë të parë në historinë e saj, Kombet e Bashkuara kanë pranuar se kushdo, kudo, ka të drejtë të jetojë në një mjedis të pastër, të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm<sup>5</sup>. Rezolutat nga Këshilli i të Drejtave të Njeriut në 2021 (A/HRC/RES/48/13) dhe Asambleja e Përgjithshme në 2022 (A/RES/76/300) e shtojnë këtë të drejtë themelore të njeriut në bibliotekën e të drejtave të njohura ndërkombëtarisht. *“Ndërsa njerëzimi përballet me një*

---

<sup>2</sup> Direktiva 2000/60/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 23 Tetor 2000 Ngritja e një kuadri ligjor për veprimet e komunitetit në fushën e politikës së ujërave

<sup>3</sup> Ligji Nr. 111/2012 i ndryshuar me ligjin nr. 6/2018, datë 8.2.2018 dhe VKM Nr. 177 datë 31.03.2005 *“Për normat e shkarkimeve të lejuara të ujit dhe kriteret e tyre të zonimit në mjedisin ujor të pranuar”*, ka transpozuar disa nga dispozitat e Direktivës së Trajtimin të Ujrave të Ndotura Urbane. Transpozimi i Direktivës së Trajtimin të Ujrave të Ndotura Urbane kërkon një ndërhyrje serioze si në aspektin ligjor, institucional ashtu edhe në burimet e shumta financiare të nevojshme për të ndërtuar infrastrukturën e nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura urbane.

<sup>4</sup> <https://digitallibrary.un.org/record/687002?ln=en>

<sup>5</sup> <https://www.ohchr.org/en/special-procedures/sr-environment>



*krizë planetare të paprecedentë, është shpresa jonë e vërtetë që e drejta për një mjedis të pastër, të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm do të shërbejë si një katalizator për ndryshimet sistematike dhe transformuese për të prodhuar një të ardhme të drejtë dhe të qëndrueshme në harmoni me natyrën”.*

Po ashtu, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë e ka parashikuar të drejtën e një mjedisi, “*për një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm*” si synim të objektivave sociale dhe përgjegjësi të shtetit, brenda kompetencave të tij.

Në këtë drejtim, shëndeti i njeriut mund të shihet si urë domethënëse midis të drejtave të njeriut dhe mbrojtjes së mjedisit, duke qenë objektivi parësor i të dy fushave të rregullimit. Të drejtat e njeriut ekzistojnë për të promovuar dhe mbrojtur mirëqenien njerëzore, për të lejuar zhvillimin e plotë të secilit person dhe maksimizimin e qëllimeve dhe interesave të personit, individualisht dhe në bashkësi me të tjerët. Parakusht për shëndetin janë mjedise të sigurt, p.sh ajri, uji dhe toka. Ndotja ndikon në klimë, e cila nga ana tjetër fillon me një sërë reagimesh që rezultojnë në fatkeqësi natyrore. Ndotja shkatërron shëndetin dhe vret, kështu që jo vetëm që shkatërron mjedisin, por shkel edhe të drejtat e njeriut.

Qeveria Shqiptare ka prioritet parësor sigurimin e shërbimeve të furnizimit me ujë, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane të menaxhuara në mënyrë eficiente dhe të sigurt, me qëllim rritjen e standardeve të jetesës dhe mirëqenies së popullsisë. Reforma e qeverisë synon përmirësimin e ofrimit të shërbimeve të furnizimit me ujë, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane, të cilat do të ndihmojnë në reduktimin e nivelit të varfërisë dhe do të kontribuojnë në rritjen dhe qëndrueshmërinë ekonomike.

Duke e trajtuar këtë çështje në një këndvështrim më specifik, evidentojmë se ju si organe kompetente, ushtroni në përputhje me legjislacionin në fuqi, funksionet dhe kompetencat tuaja, Ju si organe përgjegjëse për shqyrtimin dhe zgjidhjen e çështjes, keni lirinë dhe autoritetin e marrjes së vendimeve si dhe përdorimit të mjeteve për këtë qëllim, brenda hapësirës së normave, kritereve dhe standardeve të pranuar përgjithësisht me ligj, duke zotëruar autoritet të plotë administrativ, për të kryer shërbime, investime dhe rregullime.

Një ndër funksionet e veta të Bashkisë Durrës, në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, në përputhje me përcaktimin e dhënë në neni 23, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, është; *“...bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për: Prodhimin, trajtimin, transmetimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm, mbledhjen, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura, mbledhjen dhe largimin e ujërave të shiut dhe mbrojtjen nga përmbytjet në zonat e banuara...”*

Njësitë e vetëqeverisjes vendore mbështeten në veprimtarinë e tyre të përditshme pikërisht në konceptin e *autonomisë vendore*, të kuptuar si, *“... e drejta dhe aftësia e njërive të qeverisjes vendore, të krijuara sipas Kushtetutës dhe këtij ligji dhe në kuadër të kufizimeve të tij, që të rregullojnë dhe të administrojnë një pjesë thelbësore të çështjeve publike nën përgjegjësinë e tyre dhe në interes të bashkësisë”*, siç parashikohet në nenin 2, pika 2, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

Një rol të rëndësishëm në ushtrimin e kompetencave për ndërtimin/mirëmbajtjen e sistemeve të ujërave të ndotura, si dhe të impianteve të pastrimit të tyre, luan edhe Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Durrës, sha, e cila ka si mision të punës së saj, përmirësimin e menaxhimit në Sektorin e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve në atë zonë, për ta bërë atë më eficient, të qëndrueshëm dhe efektiv në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Për sa më sipër, Avokati i Popullit, vlerëson se Bashkia Durrës, nëpërmjet Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Durrës sha, është autoriteti përgjegjës për trajtimin e ujërave të ndotura në zonën e Hamallajt, Durrës, e më gjerë, nën juridiksionin e kësaj Bashkie.

Sipas VKM-së nr. 1304, datë 11.12.2009 “Për miratimin e modelit të rregullores “Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjellës kanalizime sh.a”, Bashkia Durrës, për funksionim dhe mirëmbajtjen e shërbimeve të ujësjellës kanalizimeve ka ngarkuar “Shoqërinë Rajonale të Ujësjellës-Kanalizimeve Durrës” Sha, të licensuar nga Enti Rregullator Kombëtar i Ujit.

MIE, Bashkitë Durrës, Kavajë, Krujë, Shijak, Rrogozhinë që posedojnë 100% aksione të kësaj shoqërie, me anë të asamblesë së aksionarëve realizojnë vendimmarrjet e rëndësishme për Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Durrës, sha, përcaktojnë natyrën dhe qëllimin e shoqërisë si edhe datën e zbatimit, zgjerimin ose riorganizimin e saj. Fakti se, për këtë funksion shërbimi, kryhet nga një shoqëri tregtare, nuk presupozon se përgjegjësia është transferuar. Ajo mbetet e bashkuar për të mbështetur këtë veprimtari në rolin e aksionerit. Pra qëllimi nuk është dhe as mund të jetë mungesa e përgjegjësisë, por krijimi i përgjegjësisë të përbashkët në nivel qendror dhe vendor për dhënien me efektivitet të shërbimit

Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Sha, Durrës, përfaqëson entin funksional dhe ekzekutiv që vepron në emër të MIE, etj, dhe që ka detyrimet dhe përgjegjësitë publike për shërbimet e furnizimin me ujë dhe të kanalizimeve të ujërave të ndotura në qytetit.

Pra, të gjitha këto akte ligjore dhe nënligjore kërkojnë dhe kanë si kusht ushtrimin e detyrave tuaja funksionale dhe marrjen e masave të menjëhershme për zgjidhjen afatgjatë të problemit të ujërave të ndotura në zonën e Hamallajt, Durrës, në përputhje me standardet e kërkuara dhe si një nevojë emergjente për të mos cenuar në asnjë rast shëndetin e qytetarëve të zonës.

Çështja e mbrojtjes së shëndetit dhe mjedisit ka qenë në vëmendjen e vazhdueshme të institucionit të Avokatit të Popullit. Problematika që prezantohet në këtë kronikë është serioze në drejtim të shëndetit të qytetarëve. Megjithëse ekziston prej vitesh ende nuk janë marrë masat e duhura për të arritur rezultate konkrete në drejtim të garantimit me cilësi të këtij shërbimi publik.

Për sa më sipër, nga informacioni i prezantuar për këtë çështje del e qartë se, zona e Hamallajt, dhe më gjerë, ndodhet në mungesë të infrastrukturës për mbledhjen/largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura. Ndër të tjera, situata bëhet më problematike, duke marrë parasysh faktin se zona është e banueshme nga një komunitet i gjerë njerëzish dhe është e urbanizuar prej vitit 1995 e vijim.

Duke analizuar specifikën e këtij rasti dhe korrespondencën zyrtare të dërguar nga ana e subjekteve shtetërore gjykojmë se është thelbësore ndërmarrja e veprimeve konkrete dhe planifikimi i investimeve në infrastrukturë për zgjidhjen e situatës së krijuar, e cila do të ndikonte në uljen e rrezikut të efekteve serioze në shëndetin publik dhe mjedisit në tërësi.

Në analizë të fakteve të mësipërme, institucioni i Avokatit të Popullit synon që jo vetëm të vërë në lëvizje organet kompetente, por dhe t'i sensibilizojë ato për vetë rëndësinë që ka kjo problematikë, ndaj ne theksojmë marrjen e veprimeve konkrete për zgjidhjen përfundimtare të problemit sikundër është menaxhimi i ujërave të ndotura, të cilat kanë ndikime negative në ekosistem dhe turizëm.

Në këtë kuadër, duke pasur parasysh se kjo është një çështje e rëndësishme për qytetarët, të cilëve duhet t'u garantohet e drejta për një mjedis të shëndetshëm dhe kanalizime. Avokati i Popullit dëshiron të sjellë në vëmendjen tuaj ushtrimin e detyrave funksionale dhe marrjen e masave të menjëhershme për përmirësimin e situatës së krijuar përmes investimeve në infrastrukturën e kanalizimeve në zonën e Hamallajt, Durrës, e më gjerë.

Në ushtrim të detyrës për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj, si dhe nxitjes së standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend, Institucioni i Avokatit të Popullit, bazuar në parashikimet e ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "*Për Avokatin e Popullit*", të ndryshuar, ligjin nr. 139/2015, "*Për vetëqeverisjen vendore*", të ndryshuar, gjen me vend të adresojë pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkisë Durrës, bashkive të tjera, si dhe AKUK, zgjidhjen e çështjes së prezantuar, në kushtet kur Shoqëria Rajonale e Ujësjellës-Kanalizimeve, Durrës, sha nuk zotëron fonde apo mjetet e mjaftueshme për arritjen e standardit dhe normave kombëtare për mbrojtjen e mjedisit në zonën në fjalë.

Referuar parashikimeve të nenit 23, pika 2, të ligjit nr. 139/2015, "*Për vetëqeverisjen vendore*", të ndryshuar, Bashkia, Durrës, është përgjegjëse në territorin e juridiksionit të vetë, për mbledhjen, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura, dhe se në kuptim dhe zbatim të parashikimit të nenit 30, pika 6 të ligjit në fjalë, qeverisja qendrore garanton njësitë të vetëqeverisjes vendore, mbështetjen e nevojshme financiare për ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të deleguara.

Gjithashtu, Avokati i Popullit, konsideron se roli i këtyre institucioneve në evidentimin e problematikave dhe dhënien e zgjidhjeve duhet të jetë proaktiv e të garantojë njohjen e situatës në terren.

Praktika e derisotme për zgjidhjen e çështjeve të tilla, tregon se, në pamundësi të mbështetjes së nevojshme financiare nga Buxheti i Shtetit, Këshilli i Ministrave, rast pas rasti, ka kryer lidhjen e marrëveshjeve për financimin e projekteve mbi bazë të të cilave është zgjidhur problemi i mbledhjes, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura.

Për sa më sipër, për të gjitha arsyet që parashtruam, bazuar në nenin 63, pika 3 të Kushtetutës ku parashikohet, se: *“Avokati i Popullit ka drejtë të bëjë rekomandimet dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga Administrata Publike...”*, si dhe në bazë të nenit 21, pika “b” të ligjit nr. 8454/1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, të ndryshuar, ku parashikohet, se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*:

## **REKOMANDOJMË**

- *Mbështetjen e Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës-Kanalizimeve sha, Durrës, nga Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve në hartimin dhe zbatimin e projektit për ndërtimin e sistemit të kanalizimeve për shkarkimin e ujërave të zeza në zonën e Hamallajt, Durrës, dhe më gjerë;*
- *Mbështetjen e nevojshme financiare të Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës-Kanalizimeve sha, Durrës, prej Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkisë Durrës, Bashkisë Bashkisë Krujë, Bashkisë Kavajë, Bashkisë Shijak, Bashkisë Rrogozhinë, për ndërtimin e sistemit të kanalizimeve për shkarkimin e ujërave të zeza në zonën e Hamallaj, Durrës, dhe më gjerë, me qëllim zgjidhjen përfundimtare të situatës, e cila do të ndikojë në uljen e rrezikut të efekteve serioze në shëndetin publik dhe mjedisit në tërësi.*

Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr. 8454 datë 4.02.1999, *“Për Avokatin e Popullit”*, të ndryshuar, lutemi na ktheni përgjigje të argumentuar brenda

afatit 30 ditor lidhur me masat ligjore dhe qëndrimin që do të mbani ndaj këtij rekomandimi,

*Duke besuar në bashkëpunimin tuaj,*

**KOMISIONERE**

**Erinda MELI**